

UDHËZIM
Nr. 383/8, datë 29.4.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E KOMITETIT SHQIPTAR TË
BIRËSIMEVE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetit Shqiptar të Birësimeve”, të ndryshuar, Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Për procedurat e birësimit të të miturve nëpërmjet Komitetit Shqiptar të Birësimeve, paguhen tarifa shërbimi, si më poshtë:

- a) Nga shtetas shqiptarë, 20 000 (njëzet mijë) lekë;
- b) Birësim me pëlqim, 10 000 (dhjetë mijë) lekë;
- c) Nga shtetas të huaj, 1 000 (një mijë) dollarë për shtetasit që vijnë nga vendet jashtë Bashkimit European; ose 700 (shtatëqind) euro për shtetasit që vijnë nga vendet e Bashkimit European.

2. Tarifa e shërbimit të paguhet në momentin e miratimit të kërkesës për birësim.

3. Të ardhurat e siguruar nga tarifat për shërbimet e birësimeve derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

4. Ngarkohet Komiteti Shqiptar i Birësimeve për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode